



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:185807

Datë: 06.02.2024

Numri i dokumentit: 05294194

C.nr.330/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Rezarta Sylejmani Voca, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.A, F.A dhe A.A ,te cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. F. M., nga Prishtina kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S. me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K. P., jurist, me objekt të padisë kompensim i dëmit si pasojë e aksidentit të komunikacionit, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik me datë 23.01.2024 në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 06.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve F.A, F.A dhe A.A nga Prishtinë, me te cilën kanë kërkuar nga e paditura Kompania e Sigurimeve S. me seli në Prishtinë që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit më datën 14.09.2015, t'ia paguaj secilit veç e veç dhe atë: për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 2,000.00 €; për friken e pësuar, shumën prej 2,000.00€, për ndihmën e huaj shumën prej 600.00€, për ushqim te përforcuar shumen prej 600.00 €, për shpenzime te shërimit 300.00 €, dhe ne emër te rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik shumen prej 600.00 €, me kamatë ligjore 8% nga dita e parashtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive, si dhe obligohen të paditurat që ti paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës deri në përfundim të kontestit, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, e nen kërcenim te përmbarrimit me dhunë.
- II. Secila pale i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

I. Kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre, më datën 08.02.2019, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S. dhe te paditurës së dytë Kompania e Sigurimeve K. e R., me objekt të kontestit kompensim i dëmit material dhe jo material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit të dt.14.09.2015. Në padi kanë theksuar se aksidenti ka si rezultat i mospërshtatjes se rregullave te Ligjit mbi Komunikacionin, nga ana e drejtuesit te automjeti i cili ka qenë i siguruar tek paditura, që për rrjedhojë ka pasur përjetimin e lëndimeve trupore të cilat i kanë përjetuar paditësit. Paditësit më pas e kanë tërhequr ne raport me te paditurën Kompania e Sigurimeve K. e R., ashtu që

procedura gjyqësore është zhvilluar vetëm në raport me te paditurën Kompania e Sigurimeve S. me seli në Prishtinë.

Përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare paditësi, përmes të autorizuarit të tij, ka theksuar se me provat materiale është dëshmuar mjaftueshëm se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve nga i siguruari i të paditurës, andaj i njëjti duhet të mbahet përgjegjës për kompensimin e dëmit material dhe jo material. Theksimet lidhur me parashkrimin e padisë i ka gjetur si te pa bazuara pasi që ka konsideruar se me paraqitjen e kërkesës për kompensim ne procedurë administrative tek e paditura, e cila konfirmohet me vet nënshkrimin e punonjësës së saj, është ndërprerë afati i parashkrimit. Tutje ka shtuar se veprimet e paditësve janë veprime aktive te cilat kane për pasojë ndërprerjen e afatit te parashkrimit, kurse pas veprimit te ndërmarrë afati fillon te rrjedhë afati rishtaz. Pas pranimit të ekspertizave mjekësore përfaqësuesi i paditësit ka bërë rregullimin e padisë në kuptimin objektiv për secilën kategori dëmi duke specifikuar shumat kompensuese, me kamatë ligjore 12% nga dita e parashkrimit te kërkesës tek e paditura, e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura KS K. e R., me seli ne Prishtine, në përgjigjen e dhënë në padi, e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit duke theksuar se bazuar ne raportin e aksidentit deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve te dy pjesëmarrësve ne komunikacion, andaj përgjegjësia ne mes te dy e paditura duhet te ndahet ne proporcionin 50%, për njërin dhe 50% për tjetrin. Tutje ka theksuar se ne bazë te kërkesës se paditësve, ne procedurë të rregullt, e paditura u ka ofruar paditëses F. A. për te gjitha format e dëmit shumen prej 205.00 euro si dhe paditësit A. A. ofertën për kompensim në shumën prej 110.00 euro. Sa i përket paditësit F. A., ka theksuar se bazuar ne dispozitat te cilat i parasheh LSDA, të njëjtit nuk i takon e drejta në kompensimin e kërkuar, pasi që ka dhënë kontribut ne shkaktimin e aksidentit dhe është i siguar tek e paditura e dytë. Me kërkesës që gjykata padinë e paditësve F. dhe A. A.ta refuzoj mbi shumat e ofruara kurse kërkesëpadinë e paditësit F. A. ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

E paditura KS S. me seli në Prishtinë, ne përgjigjen ne padi, gjatë deklarimeve të dhëna në seancat gjyqësore si dhe ne fjalën përfundimtare, e ka kontestuar ne tërësi kërkesëpadinë e paditësve si te parashkuar bazuar ne nenin 357 te Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Ka theksuar deri te aksidenti ka ardhur me pjesëmarrjen e dy automjeteve, ku automjeti B ka qenë i siguar me TPL, pranë S.U.G. A., dhe automjeti A, e cilin ne kohen e aksidentit e drejtonte F.A.. Përkundër këtij fakti, ka deklaruar, se edhe po të mos ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, kontestuese mbetet lartësia e kërkesëpadisë së precizuar e cila është përtej çdo standardi dhe praktike te krijuar për natyrën e kompensimeve te kërkuara. Me propozim për gjykatën që padinë e paditësve ta refuzoj ne tërësi si te pa bazuar për shkak te parashkrimit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

II. Provat e administruara lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: raporti i aksidentit nga Policia e Kosovës dt.14.09.2015 si dhe skica e planit, ekspertiza e komunikacionit

dt.26.10.2015, kërkesa për kompensim të dëmit material në veturë dhe jomaterial për paditësit F.A, F.A dhe A.A dt.31.01.2017, raporti nga QKUK-Qendra Emergjente nr.34747 dt.14.09.2015 për Faik Avdullahu, raporti nga QKUK-Qendra Emergjente nr.74742 dt.14.09.2015 për F.A, raporti nga QKUK-Qendra Emergjente nr.74743 dt.14.09.2015 për A. A., dëftesa e pagesës dt.16.09.2015 për F. A., dëftesa e pagesës dt.16.09.2015 për F.A, polica e sigurimit për F. A. dt.01.10.2014, certifikata e lindjes për A.A., ekspertiza teknike për vlerësimin e dëmit në makinë e dt.12.09.2023, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit, ekspertiza mjekësore e dt.07.07.2023, ekspertiza mjekësore e dt.02.10.2023 si dhe ekspertiza mjekësore e dt.22.11.2023, precizimi i kërkesëpadsisë i dt.05.12.2023.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e refuzoi kërkesëpadinë e paditësve për shkak të parashkrimit, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese legjitimitetit pasiv i të paditurës për përgjegjësinë e të siguruarit të saj. Por si çështje kryesore kontestuese deri në përfundim të kësaj procedure gjyqësore ishte nëse padia dhe kërkesëpadia e paditësve ishte e parashkruar konform dispozitave të aplikueshme nga Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrime apo nëse e njëjta nuk ishte e parashkruar, pretendime këto të kundërta nga të autorizuarit të palëve ndërgjyqëse deri në përfundim të këtij kontesti gjyqësor. Po ashtu ishte kontestuese edhe lartësia e kërkesëpadsisë pasi që e paditura KS Sigal kishte kundërshtime me arsyetimin se në rasti konkret kemi të bëjmë me ndarjen e përgjegjësisë.

Me leximin e Raportit të Aksidentit të datës 14.09.2015, të lëshuar nga Policia e Kosovës, Gjykata ka vërtetuar faktin se deri te aksidenti ka ardhur kur drejtuesi i automjetit A që ishte duke lëvizur nga drejtimi Fushe Kosove- Prishtine, duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes e humb kontrollin dhe e godet anësoren e rrugës dhe sillet prap në drejtim të Fushë Kosovës , kurse automjeti B, duke bere ndërrimin e shiritit nga shiriti i ngadalshëm, në mënyrë të pasigurt ,me pjesën e parme ia zë shiritin automjetit A. Në aksident pësojnë lëndime vozitësi i automjetit A dhe pasagjeret.

Me leximin e kërkesës për kompensimin e dëmit material në veturë dhe jomaterial të datës 31.01.2017, gjykata gjeti se paditësi F. A., përmes të autorizuarit të tij, av.F. M. kanë parashtruar kërkesën e lartcekur për kompensim të KS Sigal, e cila është pranuar nga kjo kompani, përmes punonjësit të të njëjtës, më datën 13.02.2017. Po ashtu kërkesa të njëjta kanë parashtruar edhe paditësja F.A dhe paditësi A. A. ,në po të njëjtën datë, përmes të autorizuarit të tyre.

Gjykata gjeti se paditësit F. A., F.A dhe A. A., me datë 14.09.2015 paraqitet në QKUK-Qendra Emergjente në Prishtinë, me ç ‘rast përpilohet raporti i pranimit si dhe lëndimet që i kanë pësuar, si rezultat i aksidentit në komunikacion. Më tej paditësit kishin vazhduar të bënin vizita, gjë e cila dëshmohet përmes udhëzimeve për konsultime.

Nga Polica e Sigurimit me numër 0005244022, Gjykata gjeti se paditësi F. A. veturën e ka pa pasur të siguruar të KS K. e R., me validitet nga data 02.10.2014 e deri me datën 02.10.2015.

Nga certifikata e lindjes e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, me nr. ref.19/2012 RL/19001, gjykata ka vërtetuar se paditësi A. A. ka lindur me datën 21.12.2012, nga babai F. A.dhe nga nëna F. A..

Nga ekspertiza e komunikacionit e përpiluar me datën 26.10.2015 gjykata gjeti se lidhur me aksidentin e komunikacionit të datës 14.09.2015, rreth orës 18:00,sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit nga Prokuroria Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë, ekspertja nga lëmia e komunikacionit

është angazhuar ne hartimin ekspertizës. Ekspertja ka theksuar ne aksidentin e komunikacionit te ndodhur e rrugën Fushë Kosovë- Prishtinë përballë shkollës 28 Nëntori ,kanë qenë të përfshira dy mjete motorike ,automjeti i tipit Audi 80 siguruar ne KS Kosova e Re dhe automjeti i tipit Kombi Mercedes i siguruar në KS Sigal. Ne mendimin dhe konstatimin e dhënë nga ekspertja, deri te aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimeve nga dy pjesëmarrësit e përfshirë në këtë aksident: drejtuesi i automjetit Audi 80 ,F. A., ka drejtuar automjetin ne mënyrë te pakujdesshme duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me kushtet dhe gjendjen e rrugës si dhe kufizimeve ne rrugë ,e humb kontrollin ne automjet dhe sillet ne rrugë ku nga shiriti i majtë i rrugës del në shiritin e djathtë dhe me rrotën e parë të majtë e godet ishullin e ngritur i cili ndan rrugën kryesore me rrugën anësore.

Kurse sa i përket drejtuesit të automjetit Kombi Mercedes, i cili ishte duke lëvizur ne rrugën ndihmëse, ka ndër marrë veprimin e kyqjes në rrugën magjistrale Fushe Kosovë- Prishtinë, ne mënyrë të pakujdesshme , duke kaluar me anën e përparme të mjetit në shiritin e djathte te rrugës neper te cilën ishte duke lëvizur automjeti i tipit Audi 80, duke rrezikuar këtë automjet i cili më pas humb kontrollin, duke dalë nga shiriti i majtë në shiritin e djathtë të rrugës dhe me rrotën e parë e godet ishullin e ngritur.

Për të vërtetuar natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore, respektivisht frikës së përjetuar nga paditësit, gjykata duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të palëve paditëse, ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia mjekësore. Në mendimin dhe konstatimin e dhënë të datës 07.07.2023, eksperti mjekësorë nga lëmia e ortopedisë Dr.X. S. dhe ekspertja nga lëmia e psikiatrisë Dr. V. A.-S., kanë theksuar se bazuar në dokumentacionin mjekësor të konsultuar- nga qendra emergjente ne Prishtine ku pas ekzaminimeve në qe kanë vazhduar trajtimin ambulantor si dhe pas ekzaminimeve të drejtpërdrejta të paditësve, paditësja F.A ka përjetuar lëndime trupore : ndrydhje te kokës dhe qafës, të cilat kualifikohen lëndime te lehta trupore. Dhimbje fizike te intensitetit posaçërisht te rende ka përjetuar 10 minuta, dhimbje fizike te intensitetit te rëndë ka përjetuar 24 orë, kohë pas kohe deri ne marrjen e terapisë kundër dhimbjeve; dhimbje fizike te intensitetit te mesëm , te cilat kanë zgjatur 10 ditë,kohë e rikuperimit fillestar; dhimbje fizike te intensitetit te ulët te cilat manifestohen edhe me sot, gjate sforcimeve fizike dhe ne ndryshime klimatike. Frika primare e cila ka zgjatur disa sekonda, e cila nënkupton se në momentin e aksidentimit, kohe psikologjike brenda se cilës ka përjetuar ndjenjën e përfundimit fatal; frika sekondare nënkupton prishjen e stabilitetit psikosocial aktivitetit shtese shkak te dëmtimeve te pësuar, friken rreth pasojave eventuale. Të gjitha këto shqetësime kualifikohen si; frike sekondare e intensitetit te lartë e cila ka zgjatur 24 ore, e manifestuar si reaksion akut ne stres, frik sekondare e intensitetit te mesëm e cila nënkupton reprekusionet dhe përpjekjet psikike dhe fizike që gjendja te përballohet dhe frike e intensitetit te ulet e cila ka zgjate katër muaj dhe është manifestuar me ankth, gjumë jo e rehatshëm etj. Zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka, shëmtim trupor nuk ka, kurse sa i përket ndihmës dhe kujdesit nga personi i trete, ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 10 ditësh, e cila konsiston në përgatitjen e ushqimit, mbajtjen e higjienës personale etj.. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 20 ditësh duke përfshirë ushqim te pasur me proteina, minerale dhe vitamina. Shërimi klimaterik dhe fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 14 ditësh të ndara në dy seanca nga 7 ditë.

Për paditësin A. A., ekspertet mjekësorë kane konstatuar se i njëjti ka pësuar ndrydhje te kokës, që kualifikohet si lëndim i lehtë trupor. Dhimbje fizike te intensitetit posaçërisht te rende ka përjetuar 10 minuta, dhimbje fizike te intensitetit te rëndë ka përjetuar 24 orë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve; dhimbje fizike te intensiteti te mesëm , te cilat kanë zgjatur 7 ditë, kohë e

rikuperimit fillestar; dhimbje fizike te intensitetit te ulët te cilat janë manifestuar me dhimbje koke për 21 dite resht dhe ka manifestuar me shenja neuroze dhe stresi.

Frika primare e cila ka zgjatur disa sekonda, e cila nënkupton se në momentin e aksidentimit, kohe psikologjike brenda se cilës ka përjetuar ndjenjën e përfundimit fatal; frika sekondare nënkupton prishjen e stabilitetit psikosocial aktivitetin shtese shkak te dëmtimeve te pësuar, friken rreth pasojave eventuale. Të gjitha këto shqetësime kualifikohen si; frike sekondare e intensitetit te lartë e cila ka zgjatur 24 ore, e manifestuar si reaksion akut ne stres, frik sekondare e intensitetit te mesëm e cila nënkupton reprecusionet dhe përpjekjet psikike dhe fizike që gjendja te përballohet dhe frike e intensitetit te ulet e cila ka zgjate katër muaj dhe është manifestuar me ankth, gjumë jo e rehatshëm etj. Zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka, shëmtim trupor nuk ka, kurse sa i përket ndihmës dhe kujdesit nga personi i trete, ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 7 ditësh, e cila konsiston në përgatitjen e ushqimit, mbajtjen e higjienës personale etj.. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 14 ditësh duke përfshirë ushqim te pasur me proteina, minerale dhe vitamina. Shërimi klimaterik dhe fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 7 ditësh ë ndara në dy seanca nga 7ditë.

Kurse sa i përket paditësit F. A., sipas ekspertizës mjekësore, i njëjti ka pësuar ndrydhje te qafës, , që kualifikohet si lëndim i lehtë trupor. Dhimbje fizike te intensitetit posaçërisht te rende ka përjetuar 10 minuta, dhimbje fizike te intensitetit te rëndë ka përjetuar 24 orë, kohë pas kohe deri ne marrjen e terapisë kundër dhimbjeve; dhimbje fizike te intensitetit te mesëm , te cilat kanë zgjatur 10 ditë, kohë e rikuperimit fillestar; dhimbje fizike te intensitetit te ulët te cilat janë manifestuar me dhimbje të qafës herë pas hershme deri tre muaj pas aksidentit

Frika primare e cila ka zgjatur disa sekonda, e cila nënkupton se në momentin e aksidentimit, kohe psikologjike brenda se cilës ka përjetuar ndjenjën e përfundimit fatal; frika sekondare nënkupton prishjen e stabilitetit psikosocial aktivitetin shtese shkak te dëmtimeve te pësuar, friken rreth pasojave eventuale. Të gjitha këto shqetësime kualifikohen si; frike sekondare e intensitetit te lartë e cila ka zgjatur 24 ore, e manifestuar si reaksion akut ne stres, frik sekondare e intensitetit te mesëm e cila nënkupton reprecusionet dhe përpjekjet psikike dhe fizike që gjendja te përballohet dhe frike e intensitetit te ulet e cila ka zgjate tri muaj dhe është manifestuar me ankth, gjumë jo e rehatshëm etj. Zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka, shëmtim trupor nuk ka, kurse sa i përket ndihmës dhe kujdesit nga personi i trete, ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 10 ditësh, e cila konsiston në përgatitjen e ushqimit, mbajtjen e higjienës personale etj. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 20 ditësh duke përfshirë ushqim te pasur me proteina, minerale dhe vitamina. Shërimi klimaterik dhe fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 10 ditësh brenda vitit te parë të aksidentit.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të paditësve, ka bere nxjerrjen e provës me ekspertize nga lëmia e makinerisë dhe për ekspert është caktuar N. Sh., nga lista e eksperteve gjyqësor, detyre e të cilit ishte vlerësimi i dëmit material të shkaktuar në automjetin motorik në ditën e aksidentit. Në ekspertizën e hartuar me datën 12.09.2023, eksperti ne mendimin dhe konstatimin e dhënë shpenzimet në emër të riparimit te automjetit ne tipit Audi me targa te regjistrimit 01-113-AA,me pronar F. A., arrijnë në lartësi prej 369.00 euro.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre ka bërë precizimin e kërkesëpadisë sa i përket lartësisë dhe atë **për paditësin F. A.** me kërkuar kompensimin ne emër të demit jomaterial dhe material dhe atë :për

dhimbje fizike 2,000,00 €; për frikë 2,000.00 €; për ndihmën e huaj 600.000€; për ushqim të përforcuar 600,00 €; për shpenzime të shërimit 300.00€; për rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik .600.00 €, në shumën e përgjithshme prej 7.100.00 €. **Për paditësen F.A:** Në emër të kompensimit të demit jomaterial dhe material: Për dhimbje fizike 2,000.00€; për frikë 2,000.00 €; për ndihmën e huaj 600.000€; për ushqim të përforcuar 600,00 €; për shpenzime të shërimit 300.00€; për rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik .600.00 €, në shumën e përgjithshme prej 7.100.00 €. **Për paditësin A. A** për dhimbje fizike shumen prej 2,000.00€; për frikë 2,000.00 €; për ndihmën e huaj 600.000€; për ushqim të përforcuar 600,00 €; për shpenzime të shërimit 300.00€; për rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik .600.00 €, në shumën e përgjithshme prej 7.100.00 €.

III. Baza juridike e kërkesëpadisë dhe Vlerësimi Përfundimtar i gjykatës

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligji nr. 04/L-077 (LMD) e rregullon çështjen e kompensimit të demit. Sipas dispozitës së nenit 136 të LMD-së, parashihet se kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të 'a kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, kurse me dispozitën e nenit 159 parashihet se "në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësin në bazë të fajësisë".

Neni 362 i LMD-së paragrafi 3 parasheh: "Kërkesat e siguruesit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre (3) vjet. Lidhur me paragrafin 4: "Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguarit ndaj siguruesit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, respektivisht kur i siguruari t'ia ketë shpërblyer dëmin".

Sipas nenin 357, parag. 1 të LMD-së, "Kërkesa për shpërblimin e demit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin". Kurse sipas nenit 341 par. 1 të njëjtit ligj është përcaktuar: "Me parashkrim shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit.",

Gjykata ka vlerësuar prapësimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin dhe për këtë gjykata vëren nenin 341 par. 3 të LMD-së, sipas të cilit "Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë". Kurse pretendim kryesor i palës së paditur gjatë seancave gjyqësore ka qenë se kërkesa nga padia është përfshirë në parashkrim.

Sipas nenit 342 par. 1 të LMD-së "Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër".

Sipas nenit 369 të LMD-së: "Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës."

I autorizuari e paditësve gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se në emër të paditësve ka parashtruar kërkesë për kompensim teke e paditura dhe se ky veprim ka ndikuar në ndërprerjen e afatit të parashkrimit

Andaj gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të autorizuarit të palëve paditëse dhe nga interpretimi ligjor i dispozitës 369 të LMD-së, erdhi në përfundim se për ndërprerjen e afatit të parashkrimit nuk

është e mjaftueshme që kreditori të ftoj debitorin me shkrim ose gojarisht ta përmbushë detyrën e vet. Kjo pasi që për të ardhur deri te ndërprerja e parashkrimit, në rastin konkret nuk ka qenë e mjaftueshme parashtrimi i vetëm kërkesës për kompensim tek e paditura pasi që kërkesa e pranuar nga e paditura nuk ka rezultuar me pohimin e borxhit, apo me ofrimin e ndonjë oferte, çoftë edhe me mënyra tjera të tërthorta të ndërmarrjes se veprimeve përmes pagesës së kësteve, nga te cilat rrjedhimisht do të nënkuptohej se e paditura ka shprehur vullnetin dhe gatishmërinë që ta përmbushë detyrimin karshi paditësve, e që do të kishte për pasojë ndërprerjen e afatit të parashkrimit. Kërkesa e parashtruar tek e paditura pavarësisht se është pranuar, e njëjta nuk është shqyrtuar, fakt ky i cili është provuar si nga provat e administruara ashtu edhe nga deklaratimet e te autorizuarit te paditësve ne seancën e shqyrtimit kryesor te datës 23.01.2024. Andaj paditësit nuk kanë prezantuar asnjë provë apo fakt, i cili do të kishte rëndësinë vendimtare të ndërprerjes së afatit të parashkrimit, që rrjedhimisht do të përbënte shkak që koha e kaluar e parashkrimit të mos llogaritet, dhe që parashkrimi të fillonte nga fillimi.

Si përfundim, paditësit pavarësisht parashtrimit të kërkesës tek e paditura, kanë pasur për obligim të ndërmarrin veprimin konkret para gjykatës për të realizuar kërkesat e tyre, pasi që kjo mënyrë e ndërveprimit është e rregulluar edhe te kontestet nga marrëdhënia e punës, tek te cilat parashihet afati i parashtrimit të padisë në gjykatë në rast se punëdhënësi nuk jep përgjigje lidhur me kërkesën e parashtruar te punonjësit te saj. Krejt ne fund, gjykata thekson se afati për parashtrimin e padisë është afat imperativ, i rregulluar me dispozita ligjore imperative kurse kërkesa për kompensimin e demit parashkruhet për tri vjet , prej momentit kur i dëmtuari ka kuptuar për demin ose për dëmtuesin. Interpretimi i kundërt dispozitave të lartcekura nuk është i bazuar dhe shpie deri te bërja nul e institutit të parashkrimit të padisë.

Gjykata gjeti si të bazuar pretendimin e palës së paditur se kërkesëpadija e paditësve është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet, ngase e njëjta është e parashkruar. Gjykata vlerëson se paditësit kanë pasur të drejtë të kërkojnë kompensimin e demit nga pala e paditur duke filluar nga data 14.09.2015, ngase më këtë datë paditësit kanë pësuar lëndim për të cilin kërkohet dhe nga kjo datë të njejtit kanë qenë në dijeni për demin e ndodhur. kompensim. Mirëpo padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 08.02.2019, pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor.

Nga provat e administruara dhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, gjykata vërtetoi faktin se aksidenti ka ndodhur me datën 14.09.2015 datë edhe kur është shkaktuar dëmi, për të cilin kërkohet kompensim, ndërsa padia në gjykatë është dorëzuar me datën 08.02.2019, që do të thotë pas 3 viteve. Brenda afatit ligjor 3 vjeçar paditësit jo vetëm duhej të kishin konsumuar rrugën jashtëgjyqësore të trajtimit të kërkesës së tyre për dëmshpërblim, por duhej të ngrinin edhe padi, kurse me parashtrimin e padisë pas tri viteve, te njejtit e kanë humbur mundësinë e realizimit të kërkesave për kompensimin e demit në rrugë gjyqësore.

Gjykata i ka vlerësuar theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike kontestimore. Në këtë kuptim ekspertizat mjekësore dhe atë nga lëmia e makinerisë, përkundër faktit se të njëjtat u elaboruan në këtë proces gjyqësor, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e tyre nëse të njëjtave ua falë besimin apo jo duke konsideruar se te njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike kontestimore pasi që gjykata vendosi që padinë e paditësit ta refuzoj për faktin se e njëjta është e parashkruar.

Numri i lëndës: 2019:185807
Datë: 06.02.2024
Numri i dokumentit: 05294194

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, meqenëse të autorizuarit e të paditurave në shqyrtimin kryesor deklaruan se nuk i kërkojnë të njëjtat.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 357 parag. 1 të LMD-së, lidhur me nenit 143 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL

C.nr.330/19 datë 06.02.2024

Gjyqtarja

Rezarta Sylejmani Voca

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:185807
Datë: 06.02.2024
Numri i dokumentit: 05294194